

## NJOFTIM

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”, Bashkia Elbasan ka nisur procedurën e regjistrimit të pasurisë me emërtimin “Teatri Skampa”, ndodhur në lagjen “Luigj Gurakuqi”, Z.K 8521.

Referuar shkresës nr. 482/3 prot., datë 19.02.2025 të Agjencisë së Trajtimit të Pronave si dhe Vendimit të Kthim Kompensimit të Pronave nr. 18/4 prot., datë 02.05.1996, kjo pasuri figuron në bashkëpronësi me Z. Xhavit Biçaku, Z. Emin Bakalli, Z. Veli Gjata, Z. Xhaferr Asllani dhe Z. Hasan Barja.

Nisur nga sa më sipër kërkohet që personat e lartpërmendur apo trashëgimtarët e tyre të paraqesin pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Elbasan, dokumentacionin ligjor që disponojnë në lidhje me pasurinë me emërtimin “Teatri Skampa” për të vazhduar me regjistrimin përfundimtar sipas akteve ligjore në fuqi.